REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 964120
Datë/Datum. 18.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)
Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr.i Prokurimit	UA//2016	20	3658	211
Nr.i brendshëm	AQP-AK	20	027	211

Sa i përket tenderit për

Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve per nevojat e Agjencive te Pavarura LOT: 2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16.

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*
NTSH EUROPA

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Vëllezërit Fazliu p/n/ Prishtinë

(Adresa)
Prishtinë — *10 000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
044 611 111
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*
BASTRI ADEMI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
autoserviseuropa@hotmail.com
(Adresa elektronike)

17.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

NDERMARRJA TREGETARE SHERBYESE Auto Servis EUROPA Elektro Mekanike PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit te tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie te kontratës.

Njoftimi për kontratë 28.08.2020

Dorzimi i ofertavee në e-prokurim më 07.10.2020

Dërgimi në e-prokurim -Procesverbali i hapjes së ofertave më 07.10.2020

Shkresë në e-prokurim për SQARIMIN E QMIMIT 26.10.2020

Përgjigjja e kompanisë në e-prokurim 29.10.2020

Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letra standarde në e-prokurim më 03.11.2020

Kërkesa për Rishqyrtim më 05.11.2020

Refuzimi I Kërkeses për Rishqyrtim më 10.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po ☐ Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPPsë- QËLLIMI

Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi ,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

NENI 1 QËLLIMI

Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi ,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

NENI 61 I LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5.000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj

Konsiderom që për këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti Kontratkues ka vepru pa bazë ligjore duke e anuluar këtë aktivitet të prokurimit. Vlersojm që nuk është bërë vlersimi,krahasimi dhe ekzaminimi i dosjes së tenderit në mënyrë të drejt. Qmimet të cilat ne kemi ofertuar janë qmime reale dhe që i përgjigjen nevojave dhe kërkesave të AK-së. Autoriteti Kontraktes më 26.10.2020 ka kërkuar nga ne si OE që ti sqarojm qmimet ti arsyetojm ato dhe ti dëshmojm me fatura apo deshmi tjera.

Shih si provë letren standarde per sqarim më 26.10.2020. Ne si OE për dallim nga OE të tjerë kemi arsyetuar në përpikmëri gjitha qka është kërkuar nga AK. Gjithashtu e kemi dorëzuar edhe oferten me të cilën kemi argumentuar që furnizohemi me këto produke me qmime edhe me të lira. NTSH EUROPA ka qenë e vetëdijshme për qmimet e ofertuara në këtë aktivitet të prokurimit . Ne kemi interes material-juridik këtë e themi me bindje të plotë. Ne kemi përfunduara kontrata 3 vjeqare nga AQP-ja me

qmime edhe me të lira në 11 LOTE e që i kemi përfunduar me sukes. Qmimet mund ti shihni dhe ti krahasoni edhe vet me oferten e kaluar këtë mund të ja kërkoni AK-AQP-së

Dëshmit tona AK i ka konsideruar si jo bindëse e që konsiderojm që janë bindëse duke e parë edhe QËLLIMIM e LPP-së .

Vlera e parashikuar e kësaj kontrate ka qenë 135,500.00 për 16 Lote ndërsa ne kemi ofertuar për 16 Lote 48,174.43 e që është një shumë e konsiderueshme.

NENI 1 CITOJ:

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Andaj konsiderojm që qëllimi i AK-së duke e anuluar këtë aktivitet të prokurimit nga bie ndesh me nenin 1 të LPP-së.

Pastaj:

NENI 61 I LPP-së citoj:

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

2.1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.

Autoriteti Kontraktes fare nuk e ka marrë për bazë arsyetimin tone i cili është i bazuar. AK ka shkeluar nenin 61 paragrafi 2-2.1-2.3-2.4 dhe paragrafin 3.

Si Përfundim për dallim nga 2 OE të tjerë të cilët nuk kanë dhën shpjegime apo sqarime të mjaftueshme në letrat standarde ne kemi arsyetuar mjaftueshme dhe me ofert për produke që furnizohemi me to.

Provë: Sqarimi i qmimeve në e-prokurim 29.10.2020

Edhe refuzimi I Kërkesës për Rishqyrtim është tërësisht i pa bazuar dhe si të till e kundërshtojm fuqishëm.Argumentet tona kanë qenë bindëse për AK që qmimet janë reale dhe lehtë të implementueshme. Kërkojm që OSHP-ja ti merr për bazë oferten e furnizimeve dhe arsyetimin tone për qmimet e ofertuara.

Kërkojm nga OSHP-ja që ta aprovon ANKESËN tonë si të bazuar dhe lënden ta kthen në Rivlersim duke na shpallur fitues në 15 lote pra nga Lot 2 deri në Lot 16 .

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Supozohet se mund të ketë humbje material nga mos nënshkrimi I kontratës ngase kemi interes material juridik.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura me poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën me të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*